

ARDIAN KLOSI

MË VETE A ME TJERË?

“...në Romë kam studiue edhe një herë tjetër, 4 vjet ku kam edhe doktorue. Gjatë kësaj kohe mbas sa diskutimesh u themelue revista „Shêjzat”, meritë kryesore e Koliqit që kishte eksperiencë të gjatë në këtë lami. Si thonte P. Valentini vijimi i „LEKËS” (jo i HYLLIT TË DRITËS), ndoshta për të na qitë në mend Koliqit e mue se ishim nxanës të shkollës së Jezuitëve... Merita e revistës „Shêjzat” kryesore ka qenë ajo e vijimit të traditës kulturore katolike të Shkodrës, kryekreje (në retrospektivë) *vazhdimësia e gegnishtes si variantë letrare*. Prej 1952 e kam ndjekë kambë për kambë zhvillimin apo imponimin e tosknishtes si gjuhë zyrtare. Nuk kemi polemizue fort, por jemi përpjekë ta perfekcionojmë gegnishten, tue u mbështetë në tekstet e vjetra tona, tue i dhanë gegnishtes vendin që i përket në kurset universitare. Pa modesti e për hir të vërtetës shfaq i se kontinuitetin e përdorimit të gegnishtes letrare në poezi, prozë artistike dhe ekspozitive (në këtë të fundit s’do harrue kontributi i revistave të emigracionit edhe mbas 1972), mbas mbylljes së *Shêjzat* (1975) me plot vetëdije e çova përpara unë: vepra e fundit letrare në këtë variantë të shqipes është *Palimpsest* (München New York 1991). S’po hy me lëvdue veten në gjurmimet gjuhësore, por po vë në dukje *Albanian Grammar* që përdoret si tekst kryesor kudo në Prendim në mësimin e shqipes në universitete, bile dhe në Bashkimin Sovjetik” (Martin Camaj, nga një letër drejtuar Gjon Sinishtës në San Francisko, 27 mars 1991).

Po të kundrosh këto tri vepra jete të Martin Camajt: atë letrare (në poezi, prozë e dramaturgji), atë publicistike edhe botuese që është mishëruar në „Shêjzat” dhe atë gjuhësore-pedagogjike që sintetizohet te *Albanian Grammar*, do të vëresh se në një pikëpamje, atë të përdorimit dhe kultivimit të gegnishtes letrare, ato janë tri faqe të të njëjtit *Strang*, arterie apo motor të brendshëm, mision jete që e ka ndjerë të vetin njeriu Camaj. Gjuha si lëndë pune e shkrimtarit dhe gjuha si objekt pune e studiuesit, njëkohësisht gjuha si atdhe e shtëpi, zëvendësues i atdheut të munguar dhe mjedisit të munguar shqipfolës, të gjitha këto varianti gegnisht i shqipes Camajt ia plotësoi më së miri, falë talentit të tij natyror, origjinës dhe rrënjëve që i gërmoi si pakkush (po të perifrazojmë Kafkën: me sëpatën e

gjuhës theu detin e ngrirë brenda vetes), por edhe traditës nga vinte, e cila e shoqëroi, e dhjetuar, përmes disa pak personalitetesh në diasporë.

Po për çfarë gegnishteje si variantë letrare flet Camaj? Ka një numër „gegnishtesh”: ajo e Shkodrës, ajo e Elbasanit, ajo e Kosovës, ajo e Fishtës, e Migjenit, e Xhuvanit - do të kundërshtojnë menjëherë skeptikët ose mospranuesit e një varianti letrar gegnisht të shqipes. Askush nuk shkruan ndonjë gegnishte të kodifikuar, madje as shkrimtarët kosovarë të viteve 50-60, aq më pak anarkistët e sotëm, madje- madje edhe vetë Camaj ka luhajtur në gegnishten që përdor, do të vazhdonin po këta kundërshtarë skeptikë, ekzistencëmohues.

Përgjigjen e marrim ndër të tjera në hyrjen e *Albanian Grammar*. Aty kujtohem se:

- gegnishtja ka zanore hundore e toskërishtja jo;
- *n*-ja ndërzanore e gegnishtes në toskërisht jep një *r*, pra kemi dukurinë e rotacizmit;
- diftongu *ue* i gegnishtes i korrespondon atij *ua* në toskërisht;
- *vo*-ja nistore e gegnishtes në toskërisht është *va*-
- tjetër dallim i rëndësishëm në morfologji është ekzistenca e infinitit të tipit *me punue*, *me shkue* në gegnisht, ndryshe në toskërisht ky funksion në këtë formë ose një tjetër të ngjashme nuk ekziston.

Më tej në kapitullin e fonologjisë mësojmë se gegnishtja i ruan gjatësitë e ndryshme të zanoreve të cilat krijojnë dhe opozicione minimale apo fjalë me kuptime të ndryshme falë kësaj gjatësie, diçka që toskërishtja nuk e ka. Në tërësi në sistemin fonematik Camaj dallon për zanoret 12 fonema të gegnishtja (7 orale: *i*, *e*, *ë*, *a*, *u*, *o*, *y* dhe 5 nazale: *î*, *ê*, *â*, *û*, *ÿ*), ndërkohë që toskërishtja ka vetëm 7.

Kaq? Po kaq. Natyrisht që në përshkrimet e çdo nënkapitulli të morfologjisë dhe sintaksës Camaj jep herë-herë edhe veçanti të tjera të gegnishtes por këto janë më së shumti pjesore, p.sh. të gegnishtes perëndimore ose asaj verilindore, të Dibrës etj. Ndërsa ato që vlejné për gjithë gegnishten janë vetëm sa u dhanë më lart.

Të thëna në një çerek faqe, por prapë të afta për të krijuar një sistem, një tjetër muzikalitet, të tjera ngjyime, një tjetër atmosferë, në fund të fundit një tjetër shtëpi nga ajo që ka shqiptari i jugut me toskërishten e tij. Tani, një ekonomist, një jurist, një gazetar do të rrudhë supet kur të marrë vesh se paskemi dy sisteme të ndryshme vetëm se njëra palë thotë *rânë* dhe tjetra *rërë*, se njëra palë thotë *kam me shkue* e tjetra *do të shkoj*. Kemi mirëkuptim të plotë për të gjithë këta ekonomistë, juristë, mjekë dhe s'ka asnjë dyshim se ata e të gjithë ne do të kemi vetëm një gjuhë administrate dhe pune si shumica e kombeve të Europës dhe se toskërishtja e ngritur në

nivel standardi më 1972 në këtë kuptim nuk është e rrezikuar. Por ndryshon puna me letërsinë, me shkrimtarin, me atë që e ka gjuhën shtëpinë e tij. Që të kthehemi te Camaj, ku u bashkua në një poeti dhe linguisti, shtëpia e gegnishtes, atdheu kulturor i saj është tjetër gjë nga instrumenti që përdor dikush për të hapur diçka, bie fjala një depozitë bankare, një proces gjyqësor ose një abdomen: gjuha është lënda e jetës dhe jeta vetë. Unë nuk mund të heq dorë nga një sistem tingëllimi dhe strukturimi, i cili është përdorur i shkruar, në koinenë së cilës i përkas, të paktën prej 400 vjetësh, le të kryhen reforma gjuhësore në shtetin prej nga kam ardhur unë dhe le të mos jetë i kodifikuar përfundimisht sistemi im. Ky është filli që përshkon krejt qëndresën kulturore/gjuhësore të Camajt, një fill i brendshëm, pasi ai kurrë nuk u vendos në ndonjë llogore. Përkundrazi Camaj ishte i bindur se rezistenca gjuhësore në rastin e gegnishtes mund të bëhej vetëm përmes veprash të fuqishme letrare. Gjuhën nuk e bëjnë gjuhëtarët ose aparatçikët. Ata mund të krijojnë e shumta një sistem lejimesh dhe ndalesash, një kod drejtshkrimor dhe një polici drejtshkrimore, siç u bë tek ne më 1972, por ato nuk mund të vendosin për shuarjen e plotë të një tradite të gjatë letrare, siç dhe nuk bënë dot realisht. Pa dyshim që Camaj e vlerësonte dhe rezistencën shkencore, në qoftë se mund ta shprehim kështu, ai e çmonte edhe polemikën politike-shkencore sikundër e zhvillonte miku dhe kolegu i tij Arshi Pipa (në një letër tjetër për Gjon Sinishtën, datë 20 shtator 1990, shkruan: „Kudo jam mbështetë [gjatë vizitës në Kosovë në po atë muaj, A.K.] në librin e A. Pipës „The politics of Language in soc. Albania”). Por duhet thënë se në vitet 1991-1993, sidomos gjatë vizitës së tij në Shqipëri, profesor Pipa i acaroi palët dhe i largoi kampet së tepërmi me deklaratat dhe botimet e tij, çka pati për pasojë që ish-kongresmenët e 1972-shit të shtrëngonin radhët, të hidheshin në kundërsulm dhe që përdorimi i gegnishtes të anatemohej deri në atë masë sa të quhej tentativë për përçarjen e kombit. Camaj ishte, siç e thashë, për punën me gjuhën, jo për luftën me gjuhën, një rrugë vërtetë shumë më e gjatë dhe më e vështirë, por në fund të fundit me gjasa shumë më të mëdha për mbijetesë dhe zhvillim të mëtejshëm.

Ende nuk i jemi përgjigjur pyetjes se çfarë gegnishteje përdori Camaj. Po ta krahasosh me dy poetë të tjerë të mëdhenj të Veriut, pararendës të tij, me Fishtën dhe Mjedjen, gegnishtja e Camajt është shumë më e butë, më e kthjelluar dhe kristalizuar në pikëpamje të trajtave morfologjike dhe modeleve sintaksore, por edhe në pikëpamje grafike. Fishta dhe Mjedja bie fjala përdorin me shumicë asimilimet e grupeve bashkëtingëllore si - Fishta: *njitet, kënellë, desim, granë, padá, xe* etj. etj. për *ngjitet, këndellë, vdesim, ngranë, pa-nda, nxe*; Mjedja *t'vetuna, bi, dhimet, tremun* për

t'pvetuna, mbi (mbin), dhimbet (dhimbjet), trembun etj.; të dy i reduktojnë në skaj ë-të e patheksuara: Fishta: *npër, un, shllungë, mrrina, gurt* etj. për *nëpër, unë, sh(t)ëllungë, m(b)ërrina, gurtë* (ose *gurët*); Mjedja: *atdhën, gjith, ftyrë, rrëkaj, t'kputuna* etj. për *atdhënë, gjithë, fëtyrë, rrëkaj, t'këputuna*. Bie në sy sidomos që të dy poetët e mëdhenj të Shkodrës nuk bëjnë shumë përpjekje për të përdorur trajta fjalësh që janë më të përgjithshme në shqipe, kështu kemi te Fishta shembuj plot si: *me hi, ngae, kjosha, xanë, këthellë* etj. etj. për *me hy, nge, qofsha, zanë, thellë*, po kështu te Mjedja: *lepër, qërshija, bakti, kij, dullijet* për *lepur, qershija, bagti, kingj, dëllijet* etj. etj. Edhe në sintaksë kemi veçanti, të cilat për mungesë vendi këtu nuk mund t'i trajtojmë. Të dy janë poetë me talent të buruar, por edhe gjuha e tyre është, siç do ta quante Camaj *natyrore*, sikurse ka qenë natyrore gjuha e rapsodëve të Mujit e Halilit e Gjergj Elez Alisë. E për çudi kjo ndodh te dy poetë njëkohësisht gjuhëtarë, sidomos Mjedja; as nuk mund të thuhet se janë më shumë të tillë në krijimet e fillimshkullit 20 dhe më pas e kanë „zbutur” gegnishten e tyre, pasi nuk u vërejt ndonjë ndryshim në gjuhën që përdorën deri në vdekje, përkatësisht më 1940 e 1937. Te Fishta shohim shpesh që ai është këmbëngulës në gjuhën e tij edhe pas Komisionit Letrar të Shkodrës, që vendosi qysh gjatë Luftës së parë Botërore gegnishten jugore (dialektin e Elbasanit) si gjuhë të ardhshme administrative të shtetit të ri shqiptar dhe bazë afrimi për shkrimtarët e dy varianteve të mëdha letrare, duke u nisur nga Gramatika e Weigandit më pas tekstet e hartuara nga A. Xhuvani. Fishta jo vetëm që nuk dëshiron të afrohet ndopak me këtë gegnishte „të zbutur”, ai është deri dhe armik i hapur i saj, tek e quan zgjidhje bizantine: „Ndokush intelektualsh kompetenta shqiptarë e shumë do funksjonarë, kompetence mjaft relative, të dyshimtë... paraqiten, edhe mendimi i tyre u pelqye, që për „gjuhë letrare” t'u zgjidhte jo ndonjë nder dialekte të Shqipërisë, që mund të kishte ndo' i literaturë të veten, por një gjuhë që të ngallite prej të shkrimit njani m'tjetrit të dialekteve gegë e toskë, nen emnin bizantin “Gjuhë e Elbasanit” (Nji atentat shurdhë, Hylli i Dritës 1930/12).

Po të kërkojmë në veprën e Camajt shembujt e mësipërm, do të gjejmë gjithmonë zgjidhjet e krahut të djathtë, d.m.th. si “do duhej të ishin” trajtat e Fishtës dhe Mjedjes, sikur këta të zbatonin një gegnishte më të moderuar. Në një kuptim Camaj ka lëshuar shumë kala nga kështjella e madhe e gjuhësore e rretheve franceskane dhe jezuite të Shkodrës: asimilimet e togjeve bashkëtingëllore, rëniet e shumta të ë-ve në pozicion paratheksor, thekset e shumta siç i gjejmë te Mjedja (Camaj lë vetëm ato kur e njëjta fjalë, pa këto thekse, ka kuptim tjetër); te vepra e fundit “Palimpsest” madje heq dorë edhe nga trajta *nji*, duke përdorur rregullisht *një*!

Më vete a me tjerë?

Por deri këtu. Ai mundet që i heq shtëpisë së gegnishtes së deriatyshme kthina, dhomëza, ornamente të mureve, por nuk luan shtyllat e saj. Kështu që ne nuk humbasim asnjë nga aromat, tingëllimat, ngjyrimet që do të na transmetonin poetët e tjerë të Veriut para tij, pa përmendur këtu që ai gegnishten e shtiu në punë edhe për të krijuar abstragime poetike që kurrë më parë nuk qenë lavruar në këtë variant, madje as në krejt poezinë shqipe.

Për çudi, në këtë vështrim, të gegnishtes „së moderuar” Camaj është më afër Migjenit sesa mësuesve të tij nga rrethet jezuite e franceskane. As te Migjeni nuk do t'i gjejmë ato asimilime e rënie të skajshme zanoresh, ato trajta margjinale fjalësh, sikurse te Fishta, Mjedja, Prenushi etj., edhe Migjeni shkruan një gegnishte që duket sikur tenton – jo drejt një shqipeje të përbashkët për gjithë poetët shqiptarë, kjo do të ishte dëshira e burokratëve të mëpasëm, e ngjashme me dëshirën për ta bërë Migjenin prarendës të komunizmit – por drejt një gegnishteje qytetare, pikë afrimi për gjithë shkrimtarët që përdorin këtë variant. Rruga që ai ndjek për të ardhur këtu është e ndryshme nga Camaj: Migjeni shkruan atë idiomë thjesht pse kjo i përshtatet më mirë natyrës së tij laike-qytetare, por edhe si kundërshtim i pashpallur ndaj gegnishtes së qarqeve katolike. E bën këtë pa ndonjë vetëdijësim gjuhëtari, madje ka luhatje, shkruan bie fjala një herë *shqjeton* e një herë *zhqjeton*, një herë *thelltë* e një herë *felltë* etj. Kurse Camaj vjen te gegnishtja e tij, në mënyrën më të vetëdijshme të mundur, duke shkruar ditën tekste gjuhësore e natën poezi (ose anasjelltas...).

Ja pra se ç'mund të bëjë një njeri i vetëm: Të shkruajë praktikisht në vetmi, praktikisht pa publik një vepër të tërë letrare e njëkohësisht të shpjerë para një traditë gjuhësore në rrugën e vetme që ajo mund të ecte. Një nga vëllimet më të mira poetike të tij e quajti “Njeriu më vete e me tjerë”, me sa duket duke e ndjerë se ishte e madhe, shumë e madhe barra që kishte marrë përsipër *pa tjerë*.

